

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6379  
E mërkurë, 4 gusht 2021  
çmimi 0.40 €

Pozita dhe opozita  
përplasen për punësimet  
familjare | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", TAHIR AHMETI | FAQE 4-5

# KOSOVA KA MUNGESË TË ZJARRFIKËSVE



Njohësi i çështjeve të emergjencave, njehëresh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë, Tahir Ahmeti, ka thënë se Kosova ka mungesë të madhe të resurseve

njerëzore për zjarrfikës. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka theksuar se, sipas ligjit, duhet të ketë një zjarrfikës për 1 500 banorë, ndërsa tani Kosova ka një zjarrfikës

për 2 800 - 3 000 banorë. Ahmeti ka bërë me dije se institucionet qendrore dhe lokale duhet të përgatiten për parandalimin e zjarreve fushore dhe pyjore

## AKTUALE



NJË I VDEKUR DHE  
110 RASTE TË REJA  
ME COVID NË KOSOVË | F.3

TËRNAVA PO QËNDRON NË  
EGJIPT | F.7

BAHTIRI SJELL TRENIN  
REKREATIV NË MITROVICË | F.6



## EKONOMI



QEVERIA MIRATON PROPOZIMIN  
PËR KANDIDATËT E RI  
TË BORDIT TË AKP-së | F.8

TELEKOMI I DETYROHET  
ARKEP-it MBI 10 MILIONË EURO

F.8

## SPORT

SHAQIRI I LUMTUR NË  
LIVERPOOL: MEZI PRES  
FILLIMIN E SEZONIT | F.14

RrGK-ja: Gratë,  
shumë pak të  
përfshira në  
listat zgjedhore  
të partive politike  
| FAQE 7



Kurti viziton  
Suharekën, bën thirrje  
për kujdes nga zjarret  
| FAQE 6



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Në Shqipëri vazhdojnë zjarret në male

**Vlorë, 3 Gusht** - Në Shqipëri ka vazhduar edhe të martën situata e rënduar me zjarret në malet e Qarkut të Vlorës, ku vatra më serioze është ajo në gadishullin e Karaburunit. Rreth 500 trupa ushtarake, 50 automjete nga toka, si dhe tre helikopterë nga ajri po bashkëpunojnë për t'i shuar zjarret që rrezikojnë banesat dhe Parkun Kombëtar të Llogarasë. Një numër i konsiderueshëm forcash ushtarake dhe të emergjencave

civile punuan edhe të martën pa ndërprerë për t'i shuar zjarret në qarkun e Vlorës. Ata frenuan zjarret, që ishin drejtuar drejt bazës ushtarake të Pashalimanit dhe po përpiqen të frenojnë zjarret mbi Dukat, që i janë afuar parkut kombëtar të Llogarasë.

Zyrtarët renditin, krahas Vlorës, edhe një seri operacionesh kundër zjarreve me sipërfaqe të mëdha në Fier, Përmet, Ksamil, Mamurras dhe në malin e

Tomorrit, ku kanë marrë pjesë disa qindra ushtarë dhe punonjës të tjerë.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, ka thënë, pas mbledhjes së Komitetit të Mbrojtjes Civile, se në këtë periudhë nuk mund të sjellin ndihmë vendet e rajonit, si Kroacia, Greqia e Turqia që, gjithashtu, po luftojnë me zjarret, ndërsa forcat shqiptare po bëjnë maksimumin e mundësive të tyre.



## NATO-ja dënon sulmin ndaj cisternës izraelite



**BRUKSEL, 3 Gusht** - Aleanca e NATO-s ka dënuar të martën sulmin vdekjeprurës të javës së kaluar ndaj një cisterne të operuar nga Izraeli në Gjirin e Omanit.

NATO-ja i bëri thirrje Iranit t'i respektojë rregullat ndërkombëtare të transportit.

Edhe Bashkimi Evropian dënoi sulmin duke e quajtur "të papranueshëm".

Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe dhe Izraeli thonë se Irani e kreu sulmin ndaj cisternës MV Mercer Street, duke vrarë një roje britanike të sigurisë dhe një anëtar të ekuipazhit me përkatësi

rumune.

Irani ka mohuar përfshirjen në incident.

Presidenti i ri i këtij vendi, Ebrahim Raisi, një ultra-konservator, ka paralajmëruar se do t'i përgjigjet çdo veprimi "nga armiqtë perëndimorë".

Britania e Madhe dhe Rumania janë aleatë të NATO-s. Në anën tjetër, Shtetet e Bashkuara kanë premtuar se do të ndërmarrin një "përgjigje kolektive" ndaj incidentit. Komentet janë bërë të hënën (2 gusht) nga sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken. "Liria e lundrimit është jetike për të gjithë aleatët e NATO-

s dhe duhet të garantohet në përputhje me ligjin ndërkombëtar", ka pohuar zëdhënësi i NATO-s, Dylan White. Zëdhënësjë e BE-së për çështjet e jashtme, Nabila Massrali, u tha gazetarëve se "trethanat e sakta të këtij sulmi duhet të sqarohen", duke shtuar se BE-ja i merr parasysh hetimet e kryera nga Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe dhe Izraeli.

Kryeministri izraelit, Naftali Bennett, akuzoi Teheranin se në mënyrë "frikacake" po e mohon përgjegjësinë, ndërsa ministri i Jashtëm tha se sulmi meriton një përgjigje të ashpër.

## Ambasadori rus: Uashingtoni kërkon largimin e 24 diplomatëve

**Moskë, 3 Gusht** - Ambasadori i Ruisë në Shtetet e Bashkuara, Anatoly Antonov, ka thënë se Uashingtoni u kishte kërkuar 24 diplomatëve rusë të largohen nga vendi deri më 3 shtator pasi skadojnë vizat e tyre.

Antonov nuk tha nëse kërkesa amerikane u nxit nga ndonjë mosmarrëveshje e veçantë. "Pothuajse të gjithë ata do të largohen pa u zëvendësuar sepse Uashingtoni i ka ashpërsuar papritur procedurat e lëshimit të vizave", ka thënë Antonov në një intervistë me revistën "National Interest".

Por zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Ned Price,

ka thënë se përshkrimi i situatës nga ambasadori rus ku përfshihen 24 diplomatë rusë me viza të skaduara amerikane është i pasaktë.

Duke folur në një konferencë shtypi, zëdhënësi tha se diplomatët rusë "mund të aplikojnë për një zgjatje" të vizave të tyre dhe "aplikimet e tilla shqyrtohen rast pas rasti".

Moska dhe Uashingtoni kanë pasur prej kohësh mosmarrëveshje të ndryshme për një sërë çështjesh dhe që u përkeqësuan më tej pasi presidenti amerikan Joe Biden tha se besonte se presidenti rus Vladimir Putin ishte një vrasës.

Tensionet u zbutën disi pasi presidenti Biden takoi presidentin Putin për bisedime më 16 qershor, të cilat madje çuan në kthimin e parave të disa investitorëve të huaj në bonot e thesarit të qeverisë ruse. "Shpresojmë që të mbizotërojë logjika e shëndoshë dhe të jemi në gjendje ta normalizojmë jetën e diplomatëve rusë dhe amerikanë në Shtetet e Bashkuara dhe Rusi sipas parimit të reciprocitetit", ka thënë Antonov, duke shpresuar se dialogu i filluar kohët e fundit mes Shteteve të Bashkuara dhe Ruisë mbi çështjet e sigurisë kibernetike do të vazhdojë.



## Vuhani do ta testojë gjithë popullsinë për koronavirus

**Vuhan, 3 gusht** - Autoritetet në qytetin kinez, Wuhan, do të testojnë gjithë popullsinë pas një numri rastesh pozitive me koronavirus. Wuhan ka regjistruar shtatë raste lokale të infektimit, njëherësh të

parat prej më shumë se një viti. Qyteti me 11 milionë banorë ka qenë në qendër të vëmendjes, pas identifikimit të rasteve të para me koronavirusin e ri më 2019. Aktualisht Kina po përballet

me shpërthimet më të mëdha me këtë virus, meqë autoritetet kanë raportuar për 300 raste në 10 ditë.

Rreth 15 provinca në gjithë shtetin janë prekur nga rastet e reja, të cilat kanë nxitur

qeverinë kineze të marrë vendim për testim masiv dhe masa kufizuese.

Autoritetet kanë thënë se varianti "Delta" i koronavirusit dhe turizmi i brendshëm kanë ndikuar në shpërthimet e reja.



# Pozita dhe opozita përplasen për punësimet familjare

Zyrtarët e opozitës kanë kritikuar qeverinë Kurti për punësimet familjare. Në seancën parlamentare të martën, në të cilën është diskutuar për 100 ditët e qeverisë Kurti, edhe zyrtarët e Lëvizjes Vetëvendosje ia kanë përmendur opozitës punësimet e familjarëve të tyre. Madje kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se mund të sjellë listë me qindra familjarë të zyrtarëve të PDK-së dhe të LDK-së të punësuar në Bankën Qendrore të Kosovës dhe në Telekom

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 3 GUSHT** - Përfaqësuesit e pozitës dhe të opozitës e kanë akuzuar njëri-tjetrin për punësimet familjare në institucionet publike. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe deputetja nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, janë përplasur në Kuvendin e Kosovës për emërimet familjare në institucionet publike. Konjufca iu ka drejtuar deputetes së PDK-së, Ganimete Musliu, duke i thënë se ajo ka të punësuar motrën në shërbimin e jashtëm. "A ka qenë pranimi i motrës tënde profesional në shërbimin e jashtëm të Kosovës? Nëse Gane mendon se motra jote është pranuar në mënyrë profesionale, nuk ke të drejtë të flasësh fare në Kuvend", ka thënë Konjufca. Kurse Ganimete Musliu i është kundërpërgjigjur, duke thënë se motra e saj është shkolluar në Gjermani. "Këta zotërinjtë e juaj, dajat, nipat, mbesat, tezet dhe baxhanakët, mendoni se

janë profesionistë ekselencë dhe i kanë plotësuar kriteret e konkursit. Kur janë në pyetje familjarët tanë kryqëzohen, ndërsa kur janë në pyetje familjarët e juaj e quani këtë rastësi. Ju e keni krijuar këtë standard, e tash duroni. Ti i ke pesë apo gjashtë familjarë nëpër institucione, ndërsa unë kam vetëm një në rrethin tim familjar të ngushtë dhe të gjerë", ka thënë Musliu. Më pas Konjufca ka përmendur zyrtarët partiakë që ka gjetur në Ministrinë e Punëve të Jashtme kur e kishte udhëhequr këtë ministri. "Vjet isha ministër i Punëve të Jashtme. Kur shkova i gjeta me radhë. Drejtori im ishte vëlla i shefit të grupit parlamentar të LDK-së, zëvendës drejtori ishte vëllai i ish-ministrit të Shëndetësisë, tash që po luan këtu rolin të LDK-ja dhe po e zëvendëson shefin e grupit shumë shpesh. Kurrë nuk i kam përmendur me emra, sepse nuk është në nivelin tim", ka thënë Konjufca, duke shtuar se në Kuvend mund të sjellë listën me qindra familjarë të zyrtarëve opozitarë të punësuar në institucionet publike.



## Aliu për punësimin e motrës: Qysh është ftuar s'e kam idenë

Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka folur për motrën e tij, Suljota Aliun, për të cilën ditë më parë është raportuar se është punësuar në Këshillin Drejtues të Odës së Farmacistëve të Kosovës, që është në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Në seancën parlamentare ku është diskutuar për 100 ditët e qeverisë Kurti, Aliu ka thënë se motra tij është farmacistë me profesion, duke thënë se

në Kosovë janë vetëm 90 persona që kanë këtë pozitë. Ai ka pranuar se ka ndodhur ky emërim, por ka theksuar se Ministria e Shëndetësisë dhe Oda e Farmacistëve duhet ta sqarojnë këtë gjë. "Ju e quani punësim angazhimin e Suljota Aliut, motrës time, në një komision në Odën e Farmacistëve. Ajo nuk është e punësuar tash, sepse ka qenë në spital dhe punon në barnatoren e Internos. Pra, përveç kësaj, është specialiste

e farmacisë klinike. Numri i tyre është jashtëzakonisht i vogël, rrjedhimisht gjasat që ajo ka mundur të jetë pjesë e atij komisioni janë shumë të mëdha, sepse ka qenë aktive edhe më herët, edhe në kohën kur ka qenë ministri nga partia juaj. Pra, ka bërë udhëzime për t'i ndalur hajnitë me barna të ndryshme. Ky nuk ka qenë punësim. Ajo është ftuar për ta marrë atë detyrë", ka thënë Aliu.

# Një i vdekur dhe 110 raste të reja me Covid në Kosovë

**EPOKA ERE** Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 3 GUSHT** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se, sipas të dhënave të fundit, pas 3 667 testeve, 110 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes. Të martën janë shënuar edhe dy qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shënuarve është 105 667. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 689. Në 24 orët e fundit janë dhënë 17 322 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të

gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 445 650 doza të vaksinës. Deri më sot 155 907 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Zyrtarët e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) kanë bërë me dije se rreth 90 për qind të rasteve të infektimit me Covid në Kosovë janë të lidhura me variantin "Delta" të këtij virusi. Sipas tyre, ky variant, sikur edhe në shumë vende të botës, është dominues edhe në Kosovë. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka paralajmëruar për rritje të numrit të të infektuarve me Covid-19 si pasojë e përhapjes së variantit "Delta" të këtij virusi. Sipas tij, arma e vetme kundër pandemisë është vaksinimi.





FLET PËR "EPOKËN E RE", TAHIR AHMETI

## Kosova ka mungesë të zjarrfikësve

Njohësi i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë, Tahir Ahmeti, ka thënë se Kosova ka mungesë të madhe të resurseve njerëzore për zjarrfikës. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka theksuar se, sipas ligjit, duhet të ketë një zjarrfikës për 1 500 banorë, ndërsa tani Kosova ka një zjarrfikës për 2 800 - 3 000 banorë. Ahmeti ka bërë me dije se institucionet qendrore dhe lokale duhet të përgatiten për parandalimin e zjarreve fushore dhe pyjore

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 3 GUSHT** - Njohësi i çështjeve të emergjencave dhe drejtori ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë, Tahir Ahmeti, ka bërë me dije se institucionet qendrore dhe lokale duhet të përgatiten për parandalimin e zjarreve fushore dhe pyjore. Ai ka deklaruar se këto institucione duhet ta bëjnë mobilizimin e stafit dhe sigurimin e pajisjeve të nevojshme për parandalimin e zjarreve.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Ahmeti ka thënë se në këto raste duhet të ndodhë vetëdijesimi i qytetarëve për rrezikun nga zjarret pyjore dhe fushore.

"Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, por edhe drejtoritë komunale për mbrojtje dhe shpëtim duhet të bëjnë përgatitjet maksimale profesionale për parandalimin dhe zvogëlimin e këtyre zjarreve. Duhet të përfshihet komuniteti lokal i atyre zonave ku zakonisht ndodhin zjarret, qoftë me trajnime të pjesëtarëve të komunitetit, qoftë edhe me fletushka vetëdijesuese të përgatitura për mënyrën e parandalimit dhe luftimit të këtyre zjarreve", ka deklaruar Ahmeti. Ai ka vlerësuar se në këtë mënyrë do të ndihmohen zjarrfikësit të cilët në shumë raste, edhe pse bëjnë sakrificë të madhe, e kanë të vështirë luftimin e atyre zjarreve. Ahmeti ka treguar se Kosova ka

mungesë të theksuar të zjarrfikësve. Sipas tij, numri i vogël i stafit dhe pajisjeve jo të duhura e vështirësojnë punën e zjarrfikësve. "Në bazë të ligjit për zjarrfikje dhe shpëtim, një zjarrfikës do të duhet të ishte për 1 500 banorë, ndërsa tani përafërsisht një zjarrfikës në Kosovë është për 2 800 - 3 000 banorë, pra kemi mungesë të theksuara të resurseve njerëzore. Kur kësaj i shtohet edhe ajo se edhe mjetet dhe pajisjet e zjarrfikësve nuk janë të nivelit që do të duhej të ishin, kjo edhe më shumë e vështirëson çështjen e menaxhimit të këtyre zjarreve", është shprehur Ahmeti. Njohësi i çështjeve të emergjencave ka treguar se në fushatat sensibilizuese duhen paralajmëruar qytetarët edhe

për sanksionet që i presin për zjarrvënie të qëllimshme. "Duhet paralajmëruar qytetarët për sanksionet ndëshkuese nga shkaktimi i zjarreve të qëllimshme apo nga pakujdesia. Duke u bazuar në ligjet e Republikës së Kosovës, inicimi i zjarrit që është me rrezik të përgjithshëm është vepër penale dhe sanksionohet me burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet", është shprehur ai.

**"Epoka e re":** Z. Ahmeti, për shkak të temperaturave të larta ditët e fundit zjarret pyjore dhe fushore janë shfaqur në disa pjesë të vendit. Çfarë dëmsh mund të shkaktojnë këto zjarre?

**Tahiri:** Ditët e fundit kemi pasur temperatura ekstreme në Kosovë. Si pasojë e tyre dhe e faktorit njeri, nëpër shumë vise të Kosovës kemi pasur zjarre fushore dhe pyjore. Këto zjarre kanë përfshirë dhe djegur hektarë të tërë të pyjeve dhe fushave, kanë shkaktuar dëme edhe në prona private, por edhe kanë rrezikuar jetën e qytetarëve.

**"Epoka e re":** Si e keni parë intervenimin e institucioneve kompetente në vatrat e zjarrit?

**Tahiri:** Zjarrfikësit e Kosovës që janë reaguesit e parë në këso emergjencë, prej fillimit janë munduar që me kapacitetet e tyre të vënë në kontroll këto zjarre, mirëpo është dashur të kërkojnë ndihmë edhe nga FSK-ja, Policia e Kosovës dhe KFOR-i qoftë për shkak të zonave të shumta të përfshira me zjarre, por edhe si pasojë e mungesës së resurseve njerëzore që janë në numër jashtëzakonisht të vogël.

**"Epoka e re":** Cili duhet të jetë reagimi i shoqërisë dhe institucioneve për t'u përballur me këto situata?

**Tahiri:** Institucionet përgjegjëse si AME-ja nga niveli qendror, por edhe drejtoritë komunale të emergjencave nëpër komunat e Kosovës duhet t'i bëjnë përgatitjet e nevojshme për parandalimin e zjarreve fushore dhe pyjore, duke filluar nga përgatitja dhe mobilizimi i stafit, sigurimi i mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme, e deri te

sensibilizimi dhe vetëdijesimi i qytetarëve për rrezikun nga zjarret pyjore, si dhe duke paralajmëruar qytetarët për sanksionet ndëshkuese nga shkaktimi i zjarreve të qëllimshme apo nga pakujdesia. Duke u bazuar në ligjet e Republikës së Kosovës, inicimi i zjarrit që është me rrezik të përgjithshëm është veprë penale dhe sanksionohet me burgim nga 6 muaj deri në 5

vjet.

**“Epoka e re”:** *Vatrat e zjarreve janë shfaqur në disa komuna. Sa ka Kosova kapacitete të mjaftueshme për t’u përballur me këtë situatë?*

**Tahiri:** Siç e theksova edhe më lart, institucionet emergjente, në këtë rast zjarrfikësit që janë reaguesit e parë, janë në numër mjaft të vogël në pothuajse të gjitha komunat e Kosovës. Në

bazë të Ligjit për Zjarrfikje dhe Shpëtim, një zjarrfikës duhet të jetë për 1 500 banorë, ndërsa tani përafërsisht një zjarrfikës në Kosovë është për 2 800 - 3 000 banorë, pra kemi mungesë të theksuara të resurseve njerëzore. Kur kësaj i shtohet edhe ajo se edhe mjetet dhe pajisjet e zjarrfikësve nuk janë të nivelit që do të duhej të ishin, atëherë kjo edhe më shumë e vështirëson çështjen e

menaxhimit të këtyre zjarreve.

**“Epoka e re”:** *Pothuajse për çdo vit po përsëriten situata të tilla. A është e nevojshme që institucionet të organizojnë kampanja vetëdijesuese në mënyrë që të mos përsëriten situatat e tilla?*

**Tahiri:** Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, por edhe drejtoritë komunale për mbrojtje dhe shpëtim

duhet të bëjnë përgatitjet maksimale profesionale për parandalimin dhe zvogëlimin e këtyre zjarreve. Duhet të përfshihet komuniteti lokal i atyre zonave ku zakonisht ndodhin zjarret, qoftë me trajnime të pjesëtarëve të komunitetit, qoftë edhe me fletushka vetëdijesuese të përgatitura për mënyrën e parandalimit dhe luftimit të këtyre zjarreve.

## Grenelli thotë se është gabim i madh mospjesëmarrja e Kosovës në “Open Balkan”



**TRANË, 3 GUSHT** - Pas vizitës në Serbi, ish i dërguari i presidentit Donald Trump për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, ka zgjedhur ta vizitojë Shqipërinë. Në një intervistë për “News24”, Richard Grenell ka treguar arsyen që e ka rikthyer në Ballkan pasi ka lënë detyrën e lartë në administratën Trump.

Grenelli ka thënë se është duke promovuar investimet e huaja dhe bashkëpunimin ekonomik në rajon, si e vetmja mënyrë për të

garantuar mirëqenie për të gjithë qytetarët, veçanërisht për të siguruar më shumë mundësi punësimi për brezin e ri. “Vizioni i presidentit Trump për dialogun mes Kosovës dhe Serbinë kishte të bënte me krijimin e vendeve të punës, pra me ekonominë. Ideja ishte që rajoni i Ballkanit të ecte përpara. Ne kemi folur për politikën për dekada të tëra, por nuk kishte shumë progres kur ishim vetëm të ulur në tavolinë dhe diskutonim vetëm për politikë. Kështu që, ishte dëshira

jonë që të përparonim, ta shtynim më tej duke folur për zhvillimin ekonomik, duke folur për punësimin e rinisë. Së fundmi ka qenë marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike që bëri të mundur administrata Trump, e cila ishte shumë e frytshme. Ajo që ne duam të shohim është vijimësia e atij investimi. Prandaj jam këtu. Nuk punoj më për qeverinë. Jam në sektorin privat dhe ne jemi duke parë mundësitë për të krijuar një sektor privat për

investimet e huaja në Ballkan. Këtu jemi për të parë projekte të ndryshme, për të kuptuar më mirë se çfarë investitori duhet të sjellim për investimet e huaja”, ka thënë Grenelli.

Si një diplomat që kishte nën mbikëqyrje ecurinë e bisedimeve Kosovë - Serbi, Grenelli ka komentuar edhe vendimin e Kosovës për të qenë jashtë iniciativës “Open Ballkan”.

Për të vendimi i Albin Kurtit është thjesht i gabuar. “Unë mendoj se ai duhet të jetë pjesë e një

bashkëbisedimi më të gjerë ballkanik, e ai nuk po e bën këtë. Është gabim i madh. Unë mendoj se Kosova, njerëzit e Kosovës, meritojnë të kenë vende pune, por pa qenë pjesë e këtij diskutimi ata nuk do të kenë mundësi të jenë pjesë e normalizimit të marrëdhënieve ekonomike në Ballkan dhe as të diskutimeve”, ka thënë Grenelli. Por, vizionar e ka quajtur Edi Ramën, i cili ka treguar leadership në këtë iniciativë që, sipas tij, do të krijojë më shumë vende pune për shqiptarët.


## Asfaltohen rrugicat në lagjet e fshatrave Kizhnarekë, Negroc, Nekoc e Arllat

**DRENAS, 3 GUSHT (ER)** - Drejtoria e Infrastrukturës Lokale ka përfunduar asfaltimin e disa rrugicave në fshatrat e Drenasit për ta përmirësuar jetën e qytetarëve. Drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva, ka

dalë në terren me banorë të fshatrave Kizhnarekë, Negroc, Nekoc e Arllat për t'i mbikëqyrur punimet e asfaltimeve në rrugët e lagjeve të këtyre fshatrave. Drejtori Gllareva gjatë vizitës ka thënë se të gjitha punimet janë duke u kryer sipas planit

të paraparë dhe ka vlerësuar se realizimi i këtyre projekteve, ka shumë rendësi për banorët e këtyre fshatrave dhe ka shtuar se këto janë disa nga projektet e planifikuara që do të kryhen gjatë këtij viti nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale. Në fshatin Negroc janë

asfaltuar 800 metra në lagjen Krasniqi. Në fshatin Kizhnarekë 400 metra asfalt dhe në fshatin Nekoc, përkatësisht në lagjen Sylaj, janë asfaltuar 900 metra asfalt. Edhe në lagjen Bytyqi dhe në lagjen e Xhamisë të Arllatit janë asfaltuar 1 600 metra.



## Kurti viziton Suharekën, bën thirrje për kujdes nga zjarret

**EPOKA E RE**

**Qendresa RAMA**

**SUHAREKË, 3 GUSHT** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar të martën komunën e Suharekës, për t'u njoftuar nga afër me situatën pas zjarreve që kanë shpërthyer në këtë komunë. Për gjendjen dhe dëmet e shkaktuara e ka njoftuar kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, por edhe njësitit i zjarrfikësve të Suharekës. Më pas kryeministri ka vizituar Zonën Industriale e cila ishte e rrezikuar nga përhapja e zjarreve, por që u shuan me angazhimin e madh të FSK-së, zjarrfikësve, organeve komunale dhe qendrore.

Kryeministri Kurti bëri thirrje për kujdes të shtuar në këto ditë me temperatura shumë të larta. "Duhet të jemi shumë vigilentë dhe të kujdesshëm, meqenëse edhe sot, edhe nesër, edhe pasnesër, do të jenë

temperaturat e larta dhe erërat e fuqishme e bëjnë shumë më të vështirë fikjen e zjarreve më pastaj", ka thënë ai. Kryeministri Kurti i falënderoi edhe komunat e tjera që e ndihmuan komunën e Suharekës, e cila, siç ka thënë ai, e ka një florë dhe faunë të jashtëzakonshme dhe bjeshkë shumë të pasura.

Ai ka thënë se bashkatdhetarët të cilët kanë ardhur për pushime në Suharekë, duhet të ndihen të sigurt, por ka tërhequr vërejtjen sërish për kujdes në mënyrë që zjarret që u fikën këto ditë, të mos rishfaqen. "Në veçanti dua ta falënderoj vullnetarin, qytetarin e Suharekës dhe jo vetëm të kësaj komune, të cilët bashkë me institucionet këtu, ishin në front të kësaj situatë emergjente dhe tash për tash arritën me sukses që dëmet materiale t'i kemi sa të më të vogla, ndërkaq ato njerëzore të mos na shfaqen", ka deklaruar Kurti.



## Bahtiri sjell trenin rekreativ në Mitrovicë



**MITROVICË, 3 GUSHT (ER)** - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me nënkryetarin Faruk Mujka dhe drejtorin për Arsim, Skender Avdiu, të shoqëruar nga fëmijët e institucionit parashkollor "Gëzimi Ynë", kanë realizuar një xhiro me autotrenin i cili tani e tutje do të jetë në shërbim për të gjithë qytetarët e Mitrovicës.

Fëmijët dhe të pranishmit e tjerë u shprehën të lumtur që Mitrovica tani ka një tren të tillë i cili do të ofrojë një atraksion të ri në qytet, sidomos në ditët e bukura të verës, ku qytetarët mund ta shijojnë shëtitjen me tren.

Treni do të parakalojë çdo ditë nga sheshi kryesor i qytetit deri te Liqeni Akumulues, ndërsa nisja do të bëhet çdo dy orë duke filluar nga ora 09:00.

Çmimi i biletës do të jetë 0.50 euro për person dhe mund të shfrytëzohet nga të gjitha grupmoshat. Treni aktual ka katër vagonë, ndërsa varësisht nga interesimi mund të plotësohet me vargona të tjerë.

## Organizohet panairi i produkteve të prodhuara nga prodhuesit llapjanë

**PODUJEVË, 3 GUSHT (ER)** - Në vazhdim të aktiviteteve të Ditëve të Diasporës, komuna e Podujevës organizon panairin e produkteve të

prodhuara nga prodhuesit llapjanë.

Ky panair do të zgjasë tri ditë me radhë, nga data 4 gusht deri më 6 gusht.

Produktet e prodhuesve llapjanë do të jenë të vendosura në sheshin e qytetit. "Kjo është një mundësi e mirë për secilin

prodhues llapjan, andaj komuna e Podujevës ju inkurajon për pjesëmarrje", ka njoftuar komuna e Podujevës.



# RrGK-ja: Gratë, shumë pak të përfshira në listat zgjedhore të partive politike

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 GUSHT - Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka theksuar se është duke përcjell zyrarizimin e kandidatëve për kryetar/e të komunave për zgjedhjet lokale të 17 tetorit. Sipas RrGK-së, është shqetësuese që nga kandidatët e zyrarizuar deri më tani, gratë mbesin shumë pak të përfshira në listat zgjedhore të partive politike. "RrGK vlerëson përpjekjet e disa partive për të kandiduar gra në garën për zgjedhje lokale. Sidoqoftë, përzgjedhja e deritanishme e shumicës së kandidatëve burra për kryetar/e të komunave është jashtëzakonisht problematike. Kjo praktikë e ndjekur nga partitë politike është duke pamundësuar përfshirjen e grave në jetën publike dhe ndërtimin e një shoqërie më të barabartë", thuhet në komunikatën për media të RrGK-së.

Rrjeti i Grave ua rikujton partive politike të Kosovës se neni 14 i Ligjit për Barazi Gjinore (LBGJ) i obligon ato që t'i zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes

së barabartë të burrave dhe grave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji, i cili përcakton qartë se në ato raste kur ekzistojnë pabarazitë, duhet të merren masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përsheptimit të realizimit të barazisë faktike ndërmjet grave dhe burrave në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi. "Prandaj, është e domosdoshme që të respektohet ky ligj dhe të krijohen kushtet që gratë të kenë mundësi që në mënyrë të barabartë me burrat të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse", është thënë në komunikatën e RrGK-së, duke shtuar se zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit treguan për një pjesëmarrje të madhe të grave në procesin zgjedhor dhe sollën rritje të numrit të grave në përfaqësimin politik. "Përmes votës, qytetarët treguan që duan më shumë gra në pozita udhëheqëse andaj partitë politike, përveç respektimit të LBGJ, e kanë për obligim ta respektojnë këtë vullnet dhe të ofrojnë më shumë hapësirë për gratë në zgjedhje lokale. Teksa afatet po ngushtohen dhe brenda



partive ende po diskutohet për kandidaturat e mundshme, RrGK-ja edhe një herë u bënë thirrje të gjitha partive politike që të kandidojnë sa më shumë gra për kryetare të komunave në zgjedhjet lokale dhe t'i përmbahen standardit të përfaqësimit minimal prej pesëdhjetë për qindësh në pajtim me kushtet e parapara me Ligjin për Barazi Gjinore", theksohet në

këtë komunikatë.

ReGK-ja ka kërkuar që partitë politike të angazhohen për të ofruar hapësirë për gratë në këto zgjedhje lokale duke krijuar mundësi për përfshirje në përfaqësim politik edhe të grave me aftësi të kufizuara, grave rome, ashkalike, egjiptiane, gorane dhe serbe të cilat nuk janë të përfaqësuar fare. "Gratë kanë nevoja dhe ide të ndryshme. Për

një udhëheqje gjithëpërfshirëse, është e domosdoshme përfaqësimi i tyre në organet vendimmarrëse. Ua rikujtojmë partive politike në Kosovë se përfshirja e grave në proceset vendimmarrëse është një hap i rëndësishëm në përpjekjen për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë", është thënë në komunikatën e Rrjetit të Grave të Kosovës.

## Tërnavava po qëndron në Egjipt



PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Me ftesë të myftiut të Egjiptit, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavava, po merr pjesë në konferencën e organizuar nga Myftinia e Egjiptit dhe sekretariati i përgjithshëm i myftinjve dhe institucioneve të fetvasë në botë me temë "Institucionet e fetvasë në kohën digjitale - sfidat e zhvillimit dhe mekanizmat e bashkëpunimit" e cila po mbahet në Kajro. Myftiu Tërnavava në kumtesën e tij në këtë konferencë u fokusua dhe theksoi rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve të institucioneve fetare me teknologjinë më moderne në kohën e digitalizimit. "Sidomos përgatitjen dhe ngritjen e kapaciteteve të liderëve fetarë në përdorimin e teknologjisë

informative dhe rrjeteve sociale, si dhe përdorimin e platformave dhe aplikacioneve të reja për të përcjell mesazhin e vërtetë dhe mësimet e pastra islame, duke mos lënë hapësirë për grupet e ndryshme ekstreme, që të përhapin ideologjitë e tyre radikale përmes rrjeteve sociale", theksohet në njoftimin e BIK-ut.

Në këtë konferencë po marrin pjesë mbi 85 delegacione të institucioneve fetare nga shtete të ndryshme të botës. Në ditën e parë të konferencës një pjesë e kryesuesve të delegacioneve u pritën edhe nga presidenti i Republikës Arabe të Egjiptit, Abdulfettah al Sisi. Në këtë konferencë Tërnavava po shoqërohet nga kryeimami Vedat ef. Sahiti.

## Jahjaga: INPO, urë lidhëse mes komunave dhe qytetarëve

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Ish-presidentja Atifete Jahjaga ka pritur të martën në takim drejtoreshën ekzekutive të OJQ 'Iniciativa për Progres - INPO', Albulena Nrecaj dhe Miranda Gagica.

Jahjaga përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se INPO është organizatë joqeveritare e cila që pothuajse 14 vjet merret

ekskluzivisht me qeverisjen e mirë lokale dhe prokurimin publik, duke monitoruar komunat që proceset lokale të jenë transparente dhe zyrtarët komunalë të jenë llogaridhënës ndaj qytetarëve. "Gjithashtu, INPO punon afër edhe me të rinjtë duke ofruar mundësi të edukimit joformal. Si zë i fuqishëm dhe shumë kritik, INPO shërben edhe si urë

lidhëse mes komunave dhe qytetarëve, kështu duke i informuar qytetarët për të drejtat e tyre të cilat i garantohen me ligj. Zëri i shoqërisë civile është jetik për performancë të mirë dhe të drejtë të institucioneve lokale dhe qendrore, andaj përgëzoj INPO-n për punë të palodhshme dhe profesionale", ka shkruar ish-presidentja Jahjaga.



## Qeveria miraton propozimin për kandidatët e ri të bordit të AKP-së

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Qeveria e Kosovës ka miratuar propozimin për kandidatët e ri për anëtarë të bordit të Agjencisë së Kosovës për Privatizim (AKP). Emrat e propozuar dhe miratuar nga qeveria për anëtarë të këtij bordi janë: Nazmi Mikellovci, Suzana Dautaj Surdulli, Mentor Hyseni, Vjollca Jashari, Violeta Arifi Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Halim

Muqolli dhe Avni Ajdini. Kryeministri Kurti ka thënë se, pas aprovimit të këtij propozimi, vendimi bashkë me biografinë e këtyre kandidatëve i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Kreu i ekzekutivit të vendit ka thënë se ky do të jetë bordi i fundit i AKP-së. "Ky do të jetë bordi i fundit i AKP-së në mënyrë që të hapim një etapë zhvillimore

në Republikën e Kosovës, drejt Fondit sovran, Agjencisë së Bankës Zhvillimore dhe në këtë mënyrë tjetërsimet abuzive që janë bërë në kaluarën, duke përfshirë aty edhe vrasjen enigmatike, vdekjen enigmatike të ish-kreut të AKP-së, të jenë një periudhë që e tejkalon Kosova e pavarur, e që synon përparim ekonomik për të gjithë", ka thënë Kurti.



## Telekomi i detyrohet ARKEP-it mbi 10 milionë euro



PRISHTINË, 3 GUSHT - Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar të martën raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të kompanisë Telekom i Kosovës për vitin 2020, ku u tha se si rezultat i borxheve gjendja e Telekomit është e rëndë. Në këtë mbledhje ku raportoi

ushtruesja e detyrës e kryeshefit të Telekomit, Burbuqe Hana, deputetët parashtuan pyetje të shumta, teksa thanë se Telekom i jep shërbime më të dobëta sesa operatorët e tjerë. Kryetarja e komisionit, Hykmete Bajrami, ka pyetur rreth borxhit të Telekomit në Autoritetin Rregullativ të

Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) dhe për rrjetin e dobët të internetit. Ajo ka thënë se ka vërejtur ngecje në auditimet e brendshme.

Ushtruesja e detyrës e kryeshefes së Telekomit, Burbuqe Hana, ka pohuar se komisioni i auditimit ka pasur r'i bërë tetë auditime,

por i ka bërë vetëm pesë.

Ajo ka bërë me dije se kanë 10.2 milionë euro borxhe ndaj ARKEP-it.

Deputeti i PDK-së, Hajdar Beqa, ka thënë se është i shqetësuar me shërbimet që ofron Telekom i pasi, sipas tij, shërbimet duhet të jenë më të avancuara. Ai ka

pyetur nëse Telekom i ka një vizion se si të dalë nga borxhet. Zytari kryesor financiar dhe i Thesarit, Feim Kelmendi, ka theksuar se kanë ulur shpenzimet në Telekom. Ai ka treguar se aktualisht nuk ka asnjë kontratë aktive të marketingut në Telekom.

## Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare kërkon vaksinimin e punëtorëve në Kosovë

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) ka deklaruar se me shqetësim është duke përcjell rritjen e numrit të të infektuarve nga Covid-19. Kjo odë ekonomike ka nisur


iniciativën "Së bashku kundër Covid-19". Ajo u ka bërë thirrje fuqisë punëtore për vaksinim. Duke pasur parasysh vështirësitë në luftimin dhe ndaljen e përhapjes së virusit Covid-19, OEGJK ka ftuar

anëtarët e saj dhe bizneset në vendin tonë që të angazhohen për të rikthyer dhe mbajtur normalitetin dhe për t'i parandaluar kufizimet eventuale duke promovuar dhe mbështetur fuqishëm

vaksinimin e fuqisë punëtore. Bizneset që duan të përkrahin këtë iniciativë vullnetare mund ta dërgojnë logon e tyre tek OEGJK-ja, që të publikohen në rrjete sociale të OEGJK-së si përkrahës të kësaj fushate.







AZIZ NESIN

# MBRETI TË CILIN E ZGJODHËN SORRAT

Na ishte se ç'na ishte. Në kohët e lashta në një shtet jetonte një i gJORË. Ishte i varfër saqë vështirë ngopte stomakun. Por, nuk ishte zemërkeq. E tërë dëshira e tij ishte t'u ndihmonte të tjerëve. Dëshironte t'u bënte mirë të tjerëve, mirëpo nuk dinte se si ta bënte. Shpeshherë thoshte sikur të më mjaftonte forca ime e të mund t'u ndihmoja të tjerëve... Ata që i dëgjonin këto e pyesnin:

- Si do t'u ndihmosh?

- Do të bëj mirësi, do t'u ndihmoj të gjithëve... Le të vijnë ato ditë dhe unë di se si do t'u ndihmoj.

Një ditë, teksa po bredhte malit, po lutej sikur t'i ndihmonte Zoti atij dhe t'i ndihmonte njerëzit. Një udhëtar që po vinte pas tij i dëgjo i fjalët e tij dhe i tha:

- Tungjatjeta djaloshi!

Njeriu i cili donte t'u bënte mirë të tjerëve, kur ktheu kokën, pa një udhëtar me mjekër të bardhë gjerë te barku.

- Tungjatjeta baba!, - i tha.

- Përse flet vetë më vete?

- A po kërkon diçka nga muzgu?

Burri tregonte me tërë fuqinë se si ishte djegur nga të ndihmuarit njerëzve.

Burri me mjekër të bardhë tha: - Deri më tani shumë persona kanë dashur t'u ndihmojnë të tjerëve. Po ta dije se si bëhet kjo ndihmë nuk do të doje t'u ndihmoje njerëzve. Është më e vështirë që njerëzve t'u bësh

mirë sesa t'u bësh keq. Qëkur është krijuar bota kanë dalë pak persona të cilët ia kanë dalë... edhe pse i tha burri, ai nuk e dëgjo.

- Unë nuk u ngaj të tjerëve, - i tha. Vetëm të arrij në një vend të tillë që të gjitha të këqijat do t'i zhduk nga faqja e dheut. Nuk do të ketë të uritur as të etur. Nuk do të ketë të zhveshur e të zbathur. Nuk do të ketë përlëshje, ngatërresa... Do t'i fus në rend të gjitha gjërat.

Mjekërbardhi, pasi e dëgjo, i tha: - Ti ke shumë dëshira, por nuk di si t'i realizosh. Edhe para teje kanë kaluar shumë të tillë që kanë dashur, por nuk kanë ditur se si t'ia dalin sikur ti. Ky ia ktheu: - Çfarë ka më të lehtë sesa të bësh mirë mbi këtë tokë.

Dhe mjekroshi iu kundërpërgjigj: - Pasi që ke dëshirë kaq shumë të ndihmosh, atëherë mos qëndro këtu. Shëtiti pa u ndalur. Vjen një kohë dhe një vend i tillë që ti ngrihesh aty ku do.

Personi që dëshironte të bënte mirësi, i dëgjo vetëm fjalët e fundit të mjekërbardhit, dhe eci krye më vete.

Në çdo vend që shkoi tregoi se si është djegur për t'u ndihmuar njerëzve.

Një ditë, derisa po shëtiste pa ndalur, pasi eci një natë të tërë derisa mëngjesi po zbardhte, diku larg pa një qytet. Qyteti ishte i rrethuar me mure të kalasë. Pasi kishte gjetur derën e hyrjes në qytet, ishte drejtuar

drejt saj për t'u futur brenda. Pasi që hyri brenda në qytet, u habit.

E si të mos habitej... Vendi ishte i mbushur me njerëz... Unë them se kishte njëqindmijë veta, ti thuaj treqind mijë. Nuk shihej fundi i njerëzve. Edhe vetë ishte futur në mes të turmës. Nga çdo kokë dilte një zë. Burri ua kishte vënë veshin të folurave. Thoshin kështu: - Qytetarë, unë e dëshiroj të mirën tuaj. Thoni sorrave të më bëjnë mua mbret. Sorrat le të më bëjnë mua mbret. Do ta shihni, do të bëj shumë të mira për ju. Do të rrjedhë sherbet nga lumenjtë e këtij qyteti, gurët e kalldrëmeve do të jenë prej arit. Në vend të shiut do të bëj që të bjerë shurup. Njëren dorë do ta keni në mjalte, tjetren në vaj. Do të bezdiseni nga të ngrënit çdo ditë të Zotit baklavë dhe byrek. Do të jeni aq rehat saqë ajo rehati do të filloi t'ju bezdisë. Të nderuar qytetarë, thoni sorrave le të më bëjnë mua mbret.

Burri i cili kishte dëgjuar vetëm këto fjalë, ishte habitur. Kur shikoi atë që kishte pranë, kuptoi se ishte personi i njëjtë me atë mjekërbardhin me të cilin ishte takuar në mal vite më parë...

- Tungjatjeta baba, - i tha.

Mjekroshi iu përgjigj:

- Tungjatjeta bir!

Po shoh se në këtë qytet të gjithë po flasin lloj-lloj gjërash. Përse po bërtasin?, - e pyeti mjekërbardhin.

Mjekërbardhi i tregoi: - Të gjithë

mendojnë se vetëm ata mund të bëjnë mirësi, por këtë mirësinë nuk dinë se si ta bëjnë, për atë... - i tha.

- Këta njerëz, çdoherë kështu bërtasin?!

- Jo. Nga zgjedhjet në zgjedhje bërtasin. Këtu bëhen zgjedhjet një herë në vit. Kur të vijë koha e zgjedhjeve, secili dëshiron që të zgjidhet vetë.

- Pse?

- Sepse secili mendon se vetëm ai mund të bëjë mirë. Secili dëshiron të bëjë mirë. Nuk ka të tillë që dëshirojnë të bëjnë keq.

- Çfarë zgjidhet këtu?

- Zgjedhet mbreti... Ky shtet nuk u ngjanë të tjerave shtete. Këtu nuk u mbetet trashëgimi mbretëria nga babai birit sikur në shtetet e tjera. Çdo vit zgjedhet një mbret i ri brenda popullit. Mbreti i cili zgjedhet, nëse i mban premtimet e dhëna para-prakisht, mbetet në fron, nëse nuk i mban, vitin tjetër bëhen zgjedhje të reja. Deri më tani nuk ka pasur mbret që ka qëndruar më shumë një vit.

- E përse atëherë brohorasin "sorra, sorra"?!

- Në këtë shtet sorrat e zgjedhin mbretin, për këtë arsye bërtasin kështu.

Qielli papritmas u ngrys, sepse e kaploi një plim sorrash. Nga plimi i sorrave dielli më nuk dukej fare. Përderisa sorrat po kroatnin sipër njerëzve, njerëzit thoshin: Vëlla

sorrë, vëlla sorrë, aman më zgjidh mua. Sorrat, kështu duke broho-ritur, në fluturim, njëra nga to që ishte më e madhe, lëshohej poshtë dhe filloi të sillej sipër kokës së burrit i cili shëtiste nëpër male e shpate për të bërë mirësi.

Fluturoi, fluturoi dhe, në fund, glasoi, pastaj përsëri u ngrit drejt qiellit.

Një e treta e njerëzve filluan të bërtasin duke i thënë burrit ti je bërë mbret, ti je bërë mbret.

Burri i cili ishte habitur me atë që po ndodhte, iu kthye mjekërbardhit që e kishte pranë: - Çfarë është kjo? Çfarë po ndodh?

- Këtu kështu bëhet zgjedhja e mbretit, - i tha.

- Nëse sorra glasojnë tri herë në kokën e dikujt, ai person zgjedhet mbret. Do të thotë që ti je bërë mbret nga një e treta. Lutu që sorra ta zgjedhë kokën tënde sërish.

Ende pa e përfunduar mirë fjalën, sorra përsëri glasoi në kokën e tij. Ata që po silleshin vërdallë bërtitën, duke thënë dy të tretat, ti je bërë mbret.

Që sorrat të glasojë edhe një herë në kokën e atij burrit, të gjithë pritnin glasimin e sorrës në kokën e vet, duke iu përgjatur sorrave: Vëlla sorrë, vëlla sorrë këtu!

Sorra nuk i dëgjoi kërkesat dhe lutjet e tyre.

Edhe për herë të tretë zgjodhi kokën e atij burri.

Pas kësaj, burrin, që i thoshin se je zgjedhur mbret, e bartën në shpinë deri në pallat.

Burri i cili u zgjodh mbret nuk e harroi mirësinë e sorrës që i kishte bërë. Menjëherë nxori ferman për t'i larguar të gjitha kukullat frikësuese. I dërgoi në gjykatë të gjithë ata që i kanë frikësuar dhe trembur sorrat. Nuk u ndal me kaq. Urdhëroi që çdo shtëpi t'u japë një grusht ushqim atyre. Populli vetëm se kishte filluar të pëshpëriste, mirëpo syri i mbretit nuk shihte gjë tjetër përveç sorrave. Në këtë mënyrë përfunduan vitin e parë. Më pas hynë në zgjedhje të reja. Banorët e atij shteti u mblodhën në qendër të qytetit. Përsëri të gjithë filluan t'u luten sorrave për t'i zgjedhur. Përsëri që të gjithë thoshin se duan t'u ndihmojnë njerëzve. Sorrat erdhën në formë plimi. Përsëri qielli u errësua.

Zërat e tyre krrak-krrak jehuan lart qiellit. Përderisa çdo vit një sorrë zgjidhte mbretin sipër kokës të të cilit glasonte, këtë vit sipër kokës së mbretit, nga i cili kishin parë shumë mirësi, glasonin dhjetë sorra nga tri herë. Kur ai burrë përsëri u zgjodh mbret, nuk harroi mirësinë e sorrave, prandaj e bëri obliguesi të ushqehen nga njëzetë sorra në shtëpi. Iu ndërtoi fole që të mbroheshin nga të ftohtit dhe nga era. Sorrat dita-ditës ishin shëndoshur dhe ishin dhjamosur. Secila sorrë ishte bërë sa një gjel deti.

Përsëri erdhi koha e zgjedhjeve. Populli, i cili fare nuk e donte mbretin e vjetër, po pëshpëriste vazhdimisht por, e kotë. Edhe në këto zgjedhje njëqind sorra sa gjeli i detit kishin pëlqyer përsëri kokën e mbretit të vjetër për të glasuar nga tri herë.

Personi i cili u bë mbret për herën e tretë tha: - Do të pastrohen sorrat prej morrave. Nuk do të ketë asnjë sorrë as një marrë të vetëm. Nxori ferman të tillë: Do të pastrohen këmbët e sorrave dhe do të lyhen me vaj. Sorrat, duke u shqyer mirë, ishin bërë sa një dele, si dhe dita-ditës shtoheshin. Erdhi një kohë që sorrat ishin rritur dhe shtuar aq shumë sa që nuk i zinte më as qyteti.

Përsëri erdhi koha e zgjedhjeve. Në këto zgjedhje, shumë për falënderim ndaj mbretit të vjetër, pesëqind sorra përsëri nga tri herë glasuan sipër kokës së tij. Mbreti aq mirë ishte kujdesur për sorrat sa që njerëzit i kishin braktisur shtëpitë e tyre dhe qytetin dhe kishin dalë maleve, fushave ngaqë nuk kishte mbetur vend nga sorrat. Sorrat ishin rritur posa lopët. Përsëri u organizuan zgjedhjet e reja. Sorrat bërë sa lopët kishin filluar të fluturonin në qiell. Nga zërat e tyre veshët po u shurdhoheshin.

Sorrat, për ta paguar borxhin ndaj mbretit, këtë herë të gjitha së bashku sipër kokës së mbretit lëshuan falënderim. Njerëzit, kur u afruan për ta dërguar mbretin e zgjedhur përsëri në pallat, panë një grumbull glasash sipër kokës së tij. Mbreti kishte mbetur i shtypur nën atë grumbull. Njerëzit që ndodhe-shin në vendin e ngjarjes, përsëri filluan të bërtasin: vëlla sorrë, vëlla sorrë më zgjidh mua.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Përkthyer: Fatijona Bajraj)



MARI HENRI BEL (STENDAL)

## KUJTIME EGOTISTE

Kapitulli i tretë  
(përktheu nga origjinali (nga frëngjishtja) Verjon Fasho)  
[për herë të parë në gjuhën shqipe]

(kapitujt e mëparshëm, në numrat pararendës të revistës)

21 qershor 1832.

Dashuria, më 1821, më dha një virtut aq qesharak: dëlirësinë.

Me gjithë përpjekjet e mia, në gusht 1821, Lysinzi, Baroi dhe Puatvëja, duke më parë ashtu të brengosur, ujdisen një mbrëmje të këndshme me disa vajza nga ato. Baro, aq sa kuptova më pas, ishte një ndër talentet e hershme të Parisit për këtë lloj kënaqësie fort të zgjedhur. Një vajzë për të nuk është vajzë veçse një herë kur është e para. Ai shpenzon tridhjetë mijë franga nga tetëdhjetë mijë të tjetër dhe, nga këto tridhjetë mijë, të paktën njëzet mijë me vajza rruge.

Baroi, pra, organizoi një mbrëmje me zonjën Pëti, dashnorja e tij e hershme, së cilës, beso, sapo i kishte huajtur para për të marrë një banesë (to raise a brothel), në rrugën Kadran, në cep të rrugës Montmartre, në kat të katërt.

Duhej ta takonim Aleksandrinën e cila gjashtë muaj më pas do të rronte në luks të madh me paratë e dashnorëve të pasur anglezë, asokohe një fillestare prej dy muajsh. Aty rreth orës tetë të darkës bujtëm në një sallon aq tërheqës, megjithëse në kat të katërt, me verë shampanje të ftohur me akull, me ponc të ngrohtë... Më në fund u shfaq Aleksandrina, e drejtuar nga një shërbyese e ngarkuar për ta vëzhguar por, se nga kush, s'më kujtohet. Por kjo femër duhej të kishte një autoritet të lartë, pasi pashë që nga kjo mesele e kurdisur kishte shtënë në xhep tashmë një njëzet franga. Aleksandrina u shfaq dhe i tejkaloi të gjitha pritshmëritë tona. Ishte një vajzë me shtat të derdhur, një shtatëmbëdhjetë a tetëmbëdhjetë vjeçe, jo më shumë, e formuar plotësisht tanimë, me dy sy të zinj që, më pas, i hasa në portretin e dukeshës de Urbino, të Ticianit, në galerinë e Firencës.

Përpos ngjyrës së flokëve, Ticiani bëri dhe portretin e saj. Ajo kishte shtat të derdhur, çehre pak të ndrojtur, por e buzëqeshur; me një fjalë, për t'u pirë në kupë. Sytë e shokëve të mi u magjepsën nga kjo pamje. Lysinzi i ofroi një gotë me shampanjë që ajo e refuzoi dhe të dy u zhdukën në një tjetër kthinë. Zonja Pëti na paraqiti dy vajza të tjera të hirshme, por i thamë se ajo vetë ishte më e pashme. Kishte këmbë të admirueshme, Puatvë ia zbuloi. Pas një intervali kohe të gjatë që të ngjalle frikë, Lysinzi u rikthye krejt i zbehtë.

"Për ju, Bejli (sic). Nderime për të sapoardhurin!" - thirrën njëzëri.

E gjej Aleksandrinën mbi një shtrat, paska të lodhur, pjesërisht të veshur, dhe saktësisht në pozicionin e dukeshës Urbini, në tablonë e Ticianit.

"Le të bisedojmë një dhjetë minuta", më tha ajo si me të qeshur. "Jam pak e lodhur. Shpejt do ta rigjej zjarminë e rinisë që na gëlon".

Ajo ishte e adhurueshme. Mbase kurrë në jetë s'kam parë bukuri të tillë. Përrjashtuar sytë, të cilët pak nga pak xixëllonin çmenduri dhe pasion, shthurja nuk binte në sy. Por e gjithë situata po më shkiste si rëra ndër gishta; një fiasko e plotë nga ana ime. Kërkova ndonjë mënyrë kompensimi. Ajo pranoi. Duke mos ditur realisht se ç'të bëja, desha t'i rikthehem lojës me duar të cilën ajo e refuzoi. Ajo dukej e trembur. I thashë një-dy tri fjalë, mjaft të ëmbla për pozitën ku ndodhesha, dhe u largova.

Baroi më zëvendësoi në çast, e sakaq u dëgjua shpërthime të qeshurash aq të forta sa i përshkuan të tria dhomat deri në veshin tonë. Papritur, zonja Pëti i lejoi vajzat e tjera të largoheshin dhe Baro na e solli Aleksandrinën pothuajse krejt të zhveshur.

Një bukuri që sapo ua kishte rrembyer kthetrave të gjumit.

"Admirimi im për Bejlin, - tha ai duke u zgërdhirë si i çartur, - do të bëjë që ta imitoj tani. Po fortifikohem me ca shampanjë së pari".

Të qeshurat zgjatën një dhjetë minuta. Puatvë rrokullisej mbi qilim. Habia e tepruar e Aleksandrinës dukej shumë komike. Ishte hera e parë që vajza e gjorë e kishte humbur toruan asisoj.

Këta zotërinj donin të më bindnin se do të vdisja nga turpi dhe se ai ishte çasti më fatkeq i jetës sime. Isha i befashuar, asgjë më tepër. Nuk e di pse më kishte kapluar mendimi për Metildën duke hyrë në atë dhomë ku Aleksandrina përbente stolinë më të bukur.

Përfundimisht, gjatë dhjetë vjetëve nuk kam shkuar as tri herë bashkë me vajza të kësaj sere. Dhe, pas Aleksandrinës grishëse, ajo e radhës më qe në tetor apo nëntor 1827, në një gjendje të rënduar dëshpërimi.

Një dhjetë herë e kam parë Aleksandrinën në karrocën e saj të shkëlqyer që e bleu një muaj më pas dhe gjithnjë e sodisja me ëndje. Më pas, në krye të pesë a gjashtë vjetëve, ashtu si shoqet e saj, ajo mori një çehre të rëndomtë.

Që nga ajo mesele, në praninë e tre shokëve të jetës, që rastësia m'i kishte bërë peshqesh, unë isha Impotenti plakaruq. Ky palo reputacion m'u përhap gjithandej dhe, pak apo shumë, zgjati deri kur zonja Azyr, pas performancës sime me të, raportoi të kundërtën. Ajo mbrëmje e forcoi ndjeshëm lidhjen time me Baroin, të cilin ende e kam dhe më ka përzemër. Ai është, mbase, francezi i vetëm në kështjellën e të cilit më kënaqësi do t'i kaloja një dy javë. Është zemra më e çiltër, karakteri më i panjollë, njeriu më pak mendjemprehtë dhe më pak i arsimuar që njoh. Por në këto dy cilësi: ajo e fitimit të parave para, pa luajtur kurrë në Bursë, dhe ajo e njohjes me një vajzë që e has gjatë një shëtitjeje ose në teatër, ai s'e ka shokun, sidomos në të dytën.

Kjo gjë u bë nevojë. Çdo vajzë që më herët ka ushqyer ndjenja për të i bëhet si të ishte burrë.

Një natë Metilda më foli për zonjën Binjami, mikeshën e saj. Ajo më rrëfeu një histori dashurie fort të bujshme të saj, pastaj shtoi: "Gjykojeni dhe vetë se ç'fat të zi që ka: çdo mbrëmje, dashnori i vet, me të dalë prej shtëpisë së saj, shkante te një tjetër çupkë". Mirëpo, kur u largova nga Milano, kuptova se kjo frazë morale nuk i përkiste aspak historisë së zonjës Binjami, por qe paralajmërim moral për mua.

Në fakt, çdo mbrëmje, pasi shoqëroja Metildën te kushërira e saj, zonja Traversi, tek e cila si në gjendje limontie kisha refuzuar të paraqitesha, shkoja ta përfundoja mbrëmjen te fort e hirshmjia dhe hyjnorja konteshë Kaseza. Dhe nga një tjetër marrëzi e imja, ngjashëm me atë që bëra me Aleksandrinën, një herë refuzova të isha dashnori i kësaj gruaje ende të re, ndoshta më e dashura që kam njohur në jetë, dhe e gjithë kjo për të merituar, përpara Zotit, dashurinë e Metildës. Me të njëjtin zell dhe për të njëjtën arsye, refuzova të famshmen Vignano e cila, një ditë, ndërsa gjithë të ftuarit e saj po zbrisnin shkallëve, - dhe midis dashnorëve ishte ai burrë mendjehollë, konti de Sorin, - i la njerëzit të shkonin para dhe më tha:

"Bejl, ka zëra që thonë se jeni i dashuruar pas meje!".

"Epo gabohen", - ia ktheva gjakftohtë, madje pa ia puthur as dorën në të ikur. Ky veprim i pahujshëm, ndaj kësaj gruaje me karakter aq të fortë, më bëri të urrehem për vdekje. Ajo, në një nga ato rrugët e ngushta të Milanos, kur haseshim ballë për ballë, nuk denjonte më të më përshëndeste as me kokë.

Ja tri marrëzitë e mëdha. Kurrë nuk do t'ia fal vetes rastin e konteshës Kaseza (sot njihet si femra më e mençur e që gëzon namin më të mirë në mbarë vendin).

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia")

# FALSIFIKIMI I REALITETIT DHE TË VËRTETËS

(Rreth romanit “1984” të Xhorxh Oruellit)



LIRAK KARJAGDIU

Xhorxh Oruelli lindi në Indi në vitin 1903. Emri i vërtetë i Xhorxh Oruellit është Erik Artur Bleir. Pa dyshim ai është një ndër shkrimtarët më namëmëdhenj të letërsisë moderne angleze. Studimet i bëri në Kolegjin Eton në vitin 1917, ku filloi të shkruante për disa revista të kolegjit. Nga viti 1922 deri në vitin 1927 Oruelli shërbeu në Policinë imperiale indiane. Shkrimtar u bë në vitin 1935. Në vitin 1936 ai luftoi dhe u plagos në luftën e Spanjës, duke luftuar në anën e republikanëve. Përpos në këtë luftë, mori pjesë edhe në Luftën e Dytë Botërore si pjesëtar i Gardës për Siguri të Britanisë. Gjatë viteve 1941-1943 punoi për Shërbimin e Lindjes së

BBC-së. Një kohë punoi redaktor i rubrikës së letërsisë në gazetën *Tribune* dhe bashkëpunëtor i jashtëm për dy gazeta të tjera të mirënjohura të asaj kohe, *Observer* dhe *Manchester Evening News*. Dy romanet më të njohura që i sollën popullaritet janë *Ferma e kafshëve*, të cilën e botoi në vitin 1945 dhe *1984*, që doli në dritë në vitin 1949 dhe është, pa dyshim, kryevepra e tij dhe një ndër kryeveprat e letërsisë moderne angleze. Vdiq në Londër në vitin 1950. Në vitin 1949 botoi romanin *1984*, me të cilin fitoi famë të përbotshme, duke u bërë një ndër shkrimtarët më të spikatur të letërsisë botërore. Është interesant se gati në të gjitha veprat e tij frymëzimi dhe inspirimi kryesor i tij janë pikëpamjet dhe qëllimet e tij politike. Aithoshte se letërsia s'mund të shkëputet nga politika. Sipas tij, shkrimtari që shkëputet nga politika s'është shkrimtar. Ai në esenë me titull *Përse shkruaj*, të botuar në vitin 1947, kishte paralajmëruar se do të shkruante edhe një libër të ri

dhe të fundit. Ky libër i ri dhe i fundit ishte romani *1984*. Po në këtë ese ai kishte shkruar: *Gjatë dhjetë vjetëve të fundit më së shumti kam lakmuar ta shndërroj shkrimin politik në art, duke paralajmëruar kësajsoj romanin politik 1984, që u botua një vit para shuarjes së tij.*

## Paralajmërimi i totalitarizmit

*1984* është roman politik dhe është shkruar me qëllim të paralajmërimit të shoqërisë perëndimore nga rreziqet e totalitarizmit. Oruelli ishte dëshmitar i drejtpërdrejtë i tmerreve dhe katrahurave që shkaktonin regjimet totalitare në Spanjë dhe Rusi, me qëllim që ta mbanin dhe forconin pushtetin e tyre. Ndaj ai shkroi veprën *1984* për t'i alarmuar vendet perëndimore nga rreziku i totalitarizmit, ndonëse ende nuk ishte i sigurt se si t'i qasej komunizmit, për faktin se në vitin 1949, kur e shkroi këtë vepër, Lufta e Ftohtë ende nuk kishte marrë përmasa të

mëdha. Përveç kësaj, një numër jo i vogël i intelektualëve amerikanë e mbështeste komunizmin. Së këndejmi, marrëdhëniet diplomatike midis shteteve demokratike dhe komuniste ishin mjaft të paqarta dhe konfuze. Për më tepër, atëbotë në shtypin amerikan Bashkimi Sovjetik shpeshherë përshkruhej si eksperiment i madh moral. Megjithatë, Oruelli ishte tejet i shqetësuar nga përhapja e persekutimeve dhe shtypjes në vendet komuniste, madje ai ishte çmeritur dhe lemerisur nga keqpërdorimi i teknikës dhe teknologjisë të vendeve komuniste për t'i kontrolluar, etiketuar, shpifur, denigruar, sunduar dhe shtypur qytetarët e tyre. Vlen të vihet në dukje se ky autor nuk është i vetmi shkrimtar që ka bërë përçapje për ta parashikuar ardhmërinë. Vepra të ngjashme kanë shkruar edhe shkrimtarë të tjerë anglezë si, fjala vjen, Alldos Haklli, Herbert Xhorxh Uells etj.

Ngjarjet e romanit ndodhin

në vitin 1984 në Londër, pjesë e Oqeanisë, një superfuqi e kontrolluar me dorë të fortë nga partia që udhëhiqet nga “Vëllai i Madh”. Figura e Vëllait të Madh është më e frikshmeja. Ai ndodhet në majë të piramidës. Ai është i pagabueshëm dhe i plotfuqishëm. Vëllanë e Madh nuk mund ta shohë askush. Ai është fytyra e afisheve, zëri i teleekraneve. Vëllai i Madh është figura me të cilën partia përfaqësohet përpara botës. Figura e tij ndjell frikë, dashurin dhe respekt. Ka pak figura në letërsi që përshkruhen aq të plotfuqishme, madje as Mbinjeriu i Niçes nuk është i tillë. Shteti në veprën *1984* paraqitet si shtet që nuk ka ligje, por ka vetëm një synim: bindje dhe nënshtrim të verbër dhe të plotë ndaj partisë. Shoqëria e Oqeanisë është e ndarë sipas shtresave shoqërore në: besnikë të partisë, servilë apo anëtarë të thjeshtë të partisë dhe masës që përbëhet nga proletarët. Protagonisti Uinston Smith



është një anëtar i thjeshtë i partisë i cili punon në Ministrinë e së Vërtetës (që në të vërtetë është Ministria e Gënjeshtërave dhe e Propagandës), si falsifikues i zakonshëm i arkivave. Ndonëse zyrtarisht shtiret se e respekton pushtetin, ai në të vërtetë fshehurazi punon kundër partisë. Ndërkohë, Uinston Smithi njoftohet me një vajzë të quajtur Xhulia, e cila ishte një zyrtare e nivelit më të ulët dhe e cila, po ashtu, ishte e interesuar të luftonte kundër partisë. Ata dashurohen dhe kalojnë çaste të lumtura në vendet ku nuk mund të diktohen nga syri i Vëllait të Madh. Ata kërkojnë nga O'Brajëni, një anëtar i lartë i besnikëve të partisë, që t'i vejë në kontakt me organizatën e quajtur *Vëllazëria*. Kjo forcë opozitare luftonte kundër partisë. Thuhej se udhëhiqej nga armiku kryesor i partisë, Emanuel Gollidshajni. Mirëpo, e gjitha del një mashtrim i madh, që kishte pasur për qëllim futjen në kurth të Uinston Smithit dhe Xhulies. Si rrjedhojë, ata arrestohen, ndahen dhe torturohen brutalisht. Në fund, Uinstoni kupton se nuk ka mësuar ta dojë dhe respektojë Vëllanë e Madh.

### Shpërdorimi i teknologjisë për mbajtjen dhe ruajtjen e pushtetit

Në romanin *1984* përshkruhet në mënyrë brilante funksionimi i një shoqërie totalitare, ku qeveria ka pushtet absolut. Titulli i librit *1984* kishte për qëllim që t'i alarmonte shoqëritë perëndimore se ekzistonte rreziku që brenda tridhjetë e pesë vjetëve, një variant i ngjashëm i pushtetit me atë të përshkruar në këtë vepër, mund të dalë në shesh dhe të instalohet, nëse diktatura s'do të kundërshtohet dhe luftohet me kohë, energjikisht, efektivisht dhe si duhet. Në të vërtetë në këtë vepër Oruell përshkruan në mënyrë origjinale, por edhe të trishtë shtetin që mbikëqyr, përgjon dhe përndjek çdo aspekt të jetës njerëzore, në atë masë sa që edhe një mendim i lirë ndaj pushtetit konsiderohej si shkelje e rëndë e ligjit. Protagonisti i romanit Uinston Smithi përçapet ta sfidojë pushtetin, por në këtë aventurë të rrezikshme ai zhgënjehet dhe, në fund, dështon dhe pëson. Mirëpo, është interesant se përmes veprimeve, ecejakeve, aventurave dhe torturave të Uinstonit, që nga partia shpallet armik i popullit dhe tradhtar, lexuesit zbulojnë dhe kuptojnë metodat, teknikat dhe teknologjitë nga më të ndryshmet që pushteti i përdor për t'i vënë nën zapt dhe për t'i kontrolluar qytetarët

e tij. Manipulimi psikologjik apo goditja psikologjike është një nga metodat që partia përdor për ta reduktuar dhe zhdukur aftësinë e qytetarëve për të menduar në mënyrë të pavarur. Këtë e arrin përmes një teleekrani të madh, që është i vendosur në dhomën e çdo qytetari dhe ku në mënyrë të pandërprerë zhvillohet propaganda me qëllim që çdo lëshim, gabim dhe dështim i partisë të paraqitet si arritje, rezultat, sukses dhe fitore. Njëherësh, ekranet e mëdhenj vëzhgojnë dhe përgjojnë edhe sjelljet e qytetarëve dhe i frikësojnë qytetarët, ngado që të shkojnë dhe lëvizin, përmes një fjalie që shfaqet vazhdimisht në ekran e që thotë "Vëllai i Madh po ju shikon". Madje partia shkon aq larg sa që i përdor edhe fëmijët për të spiunuar dhe për t'i denoncuar prindërit e tyre. Në të vërtetë, partia kishte themeluar një organizatë që quhej Spiunët e rinj (Zhbiruesit e rinj) dhe të cilëve ua kishte shpërlarë trurin dhe i kishte nxitur dhe detyruar të spiunojnë kundër prindërve të tyre sa herë që ata të vërenin apo diktonin ndonjë shenjë pabesnikërie ndaj partisë te prindërit apo familjet e tyre.

Përpos kësaj, partia ishte përkujdesur që t'i "disiplinojë" edhe marrëdhëniet seksuale, duke e shkurtuar dhe shndërruar seksin në një obligim, detyrë dhe mënyrë për të krijuar anëtarë të rinj të partisë. Në këtë mënyrë, partia ishte përkujdesur që t'i kanalizojë dhe transformojë shfrimet, emocionet dhe frustracionet e qytetarëve në urrejtje ndaj armiqve të partisë. Këtë e kishte arritur duke trilluar dhe sajuar armiq dhe tradhtarë të saj. Kontrolli fizik është një metodë tjetër që përdor partia për t'i mbikëqyrur qytetarët. Kështu ajo përherë i vëzhgonte lëvizjet e qytetarëve për të parë se mos ka ndonjë shenjë të pabesisë apo tradhtisë. Këto vëzhgime ishin aq rigorozë sa që vetëm një nervozë më e vockël e shfaqur në fytyrën e një qytetari mund të përfundonte me arrestimin e tij. Së këndejmi, shpeshherë sistemi nervor i qytetarit mund të bëhej armiku më i madh i tij. Pos këtyre, partia i detyronte anëtarët e saj që të bënin gjimnastikë dhe të punonin deri në orët e vona nëpër agjencitë qeveritare, duke i mbajtur qytetarët gjithnjë të rraskapitur e të molisur. Kushdo që përpiquej ta kundërshtonte partinë dënohej me "riedukim" përmes torturës sistematike dhe brutale. Kështu ndodh edhe me protagonistin e këtij romani politik, Uinstonin. Pas ushtrimit sistematik të dhunës ndaj tij, ai kandidet dhe bindet se nuk ka asgjë më të fuqishme se dhembja fizike.



Kësisoj, duke i shtrënguar qytetarët e saj që ta pranojnë dhe t'i nënshtrohen autoritetit të saj përmes dhunës së shfrenuar, partia ishte në gjendje ta kontrollonte, ta shtrembëronte dhe falsifikonte realitetin. Kjo bindje e dhunshme shkonte aq larg sa që partia përmes dhunës i shtrëngonte dhe detyronte qytetarët që të binden se  $2 + 2 = 5$  (dy plus dy bëjnë pesë). Partia përcillte dhe kontrollonte çdo burim të informatave përmes monitorimit dhe rishkrimit (apo falsifikimit) të përmbajtjeve të të gjitha gazetave dhe historisë për qëllime të saj. Po kështu, partia nuk lejonte që qytetarët të mbanin shënime, të dhëna, fotografi apo dokumente nga e kaluara. Kujtesa bëhej e paqartë, e vagullt, e dyshimtë dhe e pasigurt dhe kësodore qytetarët ishin të gatshëm të besonin çfarëdo që u shërbente dhe u thoshte partia. Duke e kontrolluar të kaluarën ata do të ishin në gjendje ta kontrollonin edhe të ardhmen. Njëherësh, duke e kontrolluar të kaluarën, partia mund t'i përligjte të gjitha veprimet e saj në të tashmen. Përmes teleekraneve të mëdha dhe mikrofonave të fshehur nëpër gjithë qytetin, partia ia kishte dalë mban që të vëzhgonte pothuajse çdo lëvizje të qytetarëve. Për më tepër, partia përdorte mekanizma dhe teknologji të sofistikuar dhe komplekse për të ushtruar kontroll në vetëdijen e qytetarëve, në shkallë të gjerë, duke filluar që nga të dhënat për prodhimtarinë ekonomike, burimet e informacionit e duke shkuar gjer te teknologjia apo makineria për torturimin e atyre që partia i konsideronte si armiq të saj.

Kjo vepër është një rrëfim paralajmërues për rreziqet politike nga regjimet

diktatoriale, e shkruar nga një mjeshtër i rrallë i prozës. Derisa proza e fillimit të shekullit XX orvatej t'ua sqaronte lexuesve se çfarë mund të bëjë politika e drejtë dhe demokratike si dhe shkenca dhe teknologjia për përparimin dhe emancipimin e shoqërisë njerëzore, ky autor rropatet t'i paralajmërojë lexuesit se çfarë pasojash të rrezikshme mund të ketë keqpërdorimi dhe abuzimi i pushtetit politik dhe i arritjeve teknike dhe teknologjike për njerëzimin.


### Spekulimi me gjuhën për qëllime politike

Një nga mesazhet më të rëndësishme të romanit *1984* është se gjuha është një nga mjetet apo elementet kryesore për formimin e opinionit publik. Prandaj, partia ishte e mendimit se nëse gjuha kontrollohet nga një agjenci politike, atëherë struktura e saj do të mund të ndryshohej dhe modifikohej në aso përmasa sa që do ta bënte të pamundur formulimin dhe artikullimin e ndonjë ideje apo mendimi tjetër kundër partisë. Sipas pushtetit totalitar të përfaqësuar nga Vëllai i Madh, kjo mund të arrihej përmes krijimit të një gjuhe të re që do ta zëvendësonte gjuhën angleze. Në të vërtetë, gjuha e re ishte gjuha zyrtare e Oqeanisë dhe ishte krijuar me qëllim të përmbushjes së nevojave ideologjike të AngloSoc (Ingsoc), apo anglishtes së socializmit. Në vitin 1984 nuk kishte ende të tillë që mund ta përdornin gjuhën e re, ndonëse artikujt kryesorë në gazetën *The Times* (Dhe Tajms) shkruheshin vetëm nga specialistët e kësaj gjuhe. Mirëpo, shpresohet se gjuha e re do ta zëvendësonte në tërësi gjuhën e vjetër (apo anglishten

standarde) deri në vitin 2050. Ndërkohë, anëtarët e partisë gradualisht kishin filluar ta përdornin dhe ta mësonin gjuhën e re, duke përdorur më dendur fjalë, terma, neologjizma dhe konstruktive gramatikore të kësaj gjuhe. Sipas tyre, deri në vitin 2050, mbase edhe më herët, pothuajse e gjithë gjuha e vjetër do të zhdukej. Si rrjedhojë, edhe e gjithë letërsia e krijuar në këtë gjuhë do të zhdukej. Veprat e shkrimtarëve famëmëdhenj si Çoseri, Shekspiri, Miltoni, Bajroni etj. do të ekzistonin vetëm në versionin e gjuhës së re. Me këtë rast, veprat e këtyre shkrimtarëve jo vetëm që do të pësonin ndryshime, por do të shndërroheshin në diçka krejtësisht të kundërt me atë që kanë qenë. Le të na kujtohet se shumë ide të Oruellit rreth gjuhës si mjet për kontrollimin e opinionit publik janë përdorur më vonë, ndonëse në mënyrë pak të modifikuar, edhe nga shkrimtarë të tjerë për të kritikuar, fshikulluar dhe satirizuar kolonializmin.

Fare në fund, është me interes të vihet në dukje se ky roman është përkthyer në gjuhën shqipe nga shkrimtari, publicisti, profesori dhe përkthyesi letrar nga Kosova, Ramiz Kelmendi, në vitin 1980, ndërsa herën tjetër në vitin 2005 nga përkthyesi nga Shqipëria, Çelo Hoxha. Pas këtij viti është përkthyer edhe nga përkthyes të tjerë nga Kosova dhe Shqipëria dhe është botuar edhe nga botues të Shqipërisë, edhe të Kosovës. Kjo flet pak a shumë për përhapjen dhe popullaritetin e këtij autori dhe kësaj vepe te shqiptarët, që fillon qysh në shekullin e kaluar dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia")



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Broja bëhet 'Intelektual', Prishtina përforcohet me Avdylin dhe Shabanin

Kampionia dhe nënkampionia e Kosovës në futboll, Prishtina dhe Drita, janë përforcuar të martën me futbollistë cilësorë. Klubin e Dritës e ka përforcuar futbollisti Rron Broja, kurse në kryeqytet kanë 'aterruar' Florent Avdyli dhe Arlind Shabani



**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 3 GUSHT** - Klubet elitare në Kosovë po vazhdojnë përforcimet për sezonin e ri të futbollit 2021/22. Drita, që është nënkampionë në fuqi, është përforcuar me futbollistin Rron Broja, i cili rikthehet në futbollin e Kosovës pas një aventure të suksesshme në futbollin e Shqipërisë. Broja ka bërë karrierë edhe në Belgjikë dhe Maqedoninë e Veriut. "Mirë se u riktheve në Superligën e Kosovës, Rron Broja, njëherësh prej lojtarëve më me vlerë vitet e fundit në superioren e Shqipërisë, që tani do të jetë një 'Intelektual' i veshur bardhë e kaltër! Broja u prit nga drejtori sportiv i klubit, Valon Zymberi, i cili i dëshiroi mirëseardhje në klubin bardhë e kaltër. Marrëveshja mes palëve është arritur deri në qershor të 2023-s. Rroni do të

bartë fanellën me numrin 4, që është edhe numri i tij i preferuar", thuhet në njoftimin e klubit gjilanas. Të martën edhe kampionia në fuqi e Superligës, Prishtina, është përforcuar me dy futbollistë, me Florent Avdylin dhe Arlind Shabanin. Avdyli ka qenë pjesë e SHF Kurda, KEK-ut, Ramiz Sadikut, Hajvalisë, Feronikelit, Trepçës, Lirisë dhe Teutës. Avdyli rikthehet nga Shqipëria në futbollin tonë, gjithashtu edhe te Prishtina, pas përvojës së mëhershme dyvjeçare si junior i skuadrës kryeqytetase. "Ta veshësh fanellën e Prishtinës është privilegj, por edhe përgjegjësi e madhe. Të luash nën logon e skuadrës e cila është më e trofeshmja në histori të futbollit të Kosovës, është një ëndërr e realizuar. Duke u rritur në rrugët e këtij qyteti, jam rritur me 'Plisat' dhe me dashurinë e qytetarëve të këtij vendi për futbollin dhe sportin në përgjithësi. Dashuria

për këtë qytet, klubin e tifozët, më bënë të mos e mendoj dy herë zgjedhjen që ta vazhdoj karrierën te Prishtina, kampionia në fuqi e Superligës së Kosovës. Rruga përpara do të jetë sfiduese, por me angazhim, vullnet e duke qenë të bashkuar, mund të bëjmë gjëra të mëdha, me synim që t'i vazhdojmë sukseset aty ku i lanë në edicionin e kaluar", ka thënë Avdyli. Të martën klubi i Prishtinës e prezantoi edhe mesfushorin e talentuar Arlind Shabani. 19-vjeçari cilësohet një prej mesfushorëve më të talentuar dhe premtes të futbollit të Kosovës, kurse ka nënshkruar me Prishtinën për tre vjetët e ardhshëm. Shabani ka kaluar nëpër pak klube, Prishtina është vetëm skuadra e pestë në karrierë. KF KEK-u nga moshat e reja (2010-2018), KF Trepça '89 (2018-2019), Ramiz Sadiku si huazim (2019-2020), FC Struga Trim-Lum (2020-2021).

SHKURT

## Challandesi mund të lë Kosovën për Zvicrën

Përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Bernard Challandes, mund të largohet nga Kosova, pasi ai po shihet si një zëvendësues ideal për trajnerin Vladimir Petkoviç. "Nau.ch" raporton se Challandes është kandidat për të qenë në krye të Kombëtares së Zvicrës. Federata zvicerane e futbollit e ka përpiluar një listë në të cilën gjendet emri i përzgjedhësit të Kosovës, Bernard Challandes dhe trajnerit francez Arsene Wenger.

## Valencia interesohet për Muriqin

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, në këtë afat kalimtar mund të largohet nga Lazio. Skuadra spanjolle Valencia ka shfaqur interesim për shtatartarin nga Prizreni, i cili vitin e kaluar është transferuar në Lazio nga Fenerbahçe për 18 milionë euro, por assesi nuk ka arritur të gjejë veten. Gjithashtu, ditët e fundit është folur se sulmuesi "dardan" mund të rikthehet sërish në Turqi, pasi Fenerbahçe e dëshiron rikthimin e tij.

## Beqiri e mposhti sëmundjen dhe i rikthehet Trepçës

Një lajm i mirë për futbollin e Kosovës dhe për ekipin e Trepçës. Portieri Arben Beqiri, i cili në vitin e kaluar ishte diagnostifikuar me tumor në lukth, tash e ka lënë sëmundjen e tij plotësisht pas dhe i është rikthyer futbollit. Përmes një postimi në "Facebook", klubi mitrovicase Trepça njoftoi që Arben Beqiri i është rikthyer futbollit dhe do të jetë pjesë e skuadrës së Trepçës në sezonin e ri. Para se ta ndërpriste futbollin përkohësisht, Beqiri ishte pjesë e Trepçës '89, kurse tash ai do të jetë pjesë e skuadrës tjetër mitrovicase, Trepçës, ku ka qenë edhe më parë, para se të kalonte te '89-shi. Beqiri me Trepçën sezonin që vjen do të garojë në Ligën e Parë të Kosovës, për të luftuar për rikthimin në Superligë pas disa vjetëve.

## Broja kërkohet nga Udinese

Ekspteri i merkatos Fabricio Romano ka njoftuar se skuadra e Udineses ka kërkuar nga Chelsea huazimin e Armando Brojës deri në qershor të vitit 2022. Gazetari italian bën me dije se bisedimet mes dy klubeve po vazhdojnë, teksa pritet me mjaft interes të mësohet se cila do të jetë e ardhmja e shqiptarit, që disa ditë më parë rinovoi kontratën me kampionët në fuqi të Ligës së Kampionëve. Pas shkëlqimit me Vitesse në Holandë, në sezonin që sapo u mbyll, sulmuesi 19-vjeçar pritet të huazohet në një kampionat më të fortë, për të fituar më shumë përvojë dhe për t'u konfirmuar si një bomber i klasës së lartë.

## Njeriu më i shpejtë në botë: Ëndrrat nuk ishin kaq të bukura sa realiteti

TOKIO, 3 GUSHT - Njeriu më i shpejtë në botë, Marcell Jacobs, më në fund ka thënë fjalët e para pas triumfit në Lojërat Olimpikë në Tokio. Atleti italian i mahnit të gjithë me kohën 9.8 sekonda,

duke u bërë i pari italian që arrin të fitojë garën e 100 metrave në Olimpiadë. Në intervistën dhënë për "Gazzetta dello Sport", ai është shprehur: "Nuk kam arritur asgjë. Ishte diçka e bukur të dëgjoje

himnin kur isha në podin me një medalje në qafë që peshonte 1 kuintal. Ishte një emocion unik. Ëndrrat kur i shihja nuk ishin kaq të bukura sa realiteti. Nga e diela nuk kam fjetur. Provoja të flija,

por nuk arrija. Shihja gjithçka që thuhej në Itali, në rrjetet sociale. Kam pasur një mbështetje të madhe nga të gjithë. Ishte fantastike, pasi nuk prisja diçka të tillë", ka thënë Jacobs.



## Shaqiri i lumtur në Liverpool: Mezi pres fillimin e sezonit

LIVERPOOL, 3 GUSHT - Futbollisti shqiptar Xherdan Shaqiri për "Liverpoolfc.com" ka folur për edicionin e ri. Rezentuesi i Zvicrës ishte një lojtarë më të mirë në Kampionatin Evropian "Euro 2020" dhe pas përfundimit të tij u spekulua që ai do të largohet nga Liverpooli, por ai ka bërë me dije se është i lumtur në Liverpool dhe se mezi pret sezonin e ri. "Jam i lumtur që jam me skuadrën. Po ndihem mirë dhe mezi pres t'i nisim ndeshjet parasezonale dhe një sezon të mirë. Ne kishim një kampionat shumë të mirë me Zvicrën. Bëmë histori së bashku dhe jam i lumtur për këtë gjë. Unë vetëm po pres fillimin e sezonit të ri dhe t'i arrijmë objektivat me skuadrën, të fitojmë dhe të japim 100 % nga vetja jonë. Pastaj e shohim çfarë do të ndodhë, normalisht që ne duam të fitojmë gjithçka", ka thënë Shaqiri. "Ne i kemi të gjitha kualitetet për të qenë në majë të tabelës. Kemi skuadër të mirë me karaktere të mira. Për ta arritur atë gjë, ne duhet të jemi të bashkuar si skuadër, si lojtarë dhe duhet të



punojmë së bashku si skuadër. Me talentin tonë dhe dedikimin tonë ne mund të bëjmë gjëra të mëdha", ka deklaruar Shaqiri.

## Kosova U17 zhvillon dy miqësore me Shqipërinë U17

PRISHTINË, 3 GUSHT - Përfaqësuesja e Kosovës U17 në futboll gjatë muajit shtator do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore me Kombëtaren e Shqipërisë U17. Këto dy miqësore zhvillohen në kuadër të përgatitjeve të të dyja ekipeve për ciklin kualifikues të Kampionatit Evropian që do të zhvillohet në muajin tetor. "Të dyja federatat tashmë janë marrë vesh që këto ndeshje të luhen në Prishtinë, më 22 dhe 24 shtator. Këto miqësore do t'i shërbejnë përzgjedhësit Arsim Abazi dhe stafit të tij që t'i kenë sa më të qarta idetë rreth grupit të lojtarëve që do t'i kenë në shërbim në ndeshjet kualifikuese", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës. "Dardanët" U17 në kualifikime bëjnë pjesë në Grupin 9, ku janë të përfshira



edhe Austria, që është nikoqire e ndeshjeve të këtij grupi, Sllovenia dhe Ishujt Faroe. Përfaqësuesja U17 në prill të këtij viti ka zhvilluar dy miqësore me Bullgarinë, të cilat

janë mbyllur bars, derisa në qershor është mbajtur edhe një kamp përgatitor në Hajvali, me lojtarë nga kampionati vendor dhe me lojtarë që luajnë në vendet evropiane.

### SHKURT

#### 294 të prekur nga Covidi në 'Tokio 2020'

Virusi korona po vazhdon të jetë i pranishëm edhe në Lojërat Olimpikë të Tokios në Japoni. Nga ky virus numri i të prekurve arriti në 294. Komiteti Organizativ ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit nga Covid-19 janë prekur 18 persona, në mesin e tyre edhe një garues, shkruan "Anadolu". Në mesin e të infektuarve janë 10 punonjës, pesë zyrtarë dhe një anëtar i medias që shërbejnë brenda fushës së turneut. Të gjithë të infektuarit janë vendosur në karantinë.

#### ShBA-ja mposhti Spanjën, kalon në gjysmëfinale në Tokio

ShBA-ja ka kaluar në gjysmëfinale të garës së meshkujve në basketbollin e Lojërave Olimpikë në Tokio, pasi e mundi Spanjën në një çerekfinale fantastike. Amerikanët nuk e nisën mirë takimin dhe po humbnin me 10 pikë dallim kah fundi i çerekut të dytë, por i mahnitshmi Kevin Durant i udhëhoqi ata drejt fitores 95:81. Duranti i shënoi 29 pikë për t'ia mbajtur gjallë ShBA-së shpresat për medalje të artë në Tokio. Ricky Rubio ishte i shkëlqyeshme për Spanjën, duke i shënuar plot 38 pikë, por as kjo nuk u mjaftoi spanjollëve për ta ndalur ShBA-në. Në gjysmëfinale, ShBA-ja do të përballlet me fituesin e duelit çerekfinal mes Australisë dhe Argjentinës.

#### Simone Biles e fiton medaljen e bronzë olimpikë

Simone Biles e ka fituar medaljen e bronzë në finalen e trarit të ekuilibrit në Lojërat Olimpikë në Tokio, në rikthimin e saj në garën olimpikë të gjimnastikës. Triumfi i saj sot është mjaft domethënës për të, pasi para disa ditëve ajo ishte tërhequr nga gara, pikërisht në këtë Olimpiadë. Gjimnastja amerikane nuk ka garuar që prej finales ekipore javën e kaluar, ku ajo u paraqit në kërcim kali, por jo edhe në aparaturat e tjera, duke thënë se donte ta mbronte shëndetin mendor. 24-vjeçarja, katër herë kampione olimpikë, vlerësohet si gjimnastja më e mirë amerikane në histori dhe ishte favorite para lojërave. Biles e fitoi medaljen e bronzë në "Rio 2016".

#### Kane mungon në stërvitje, Tottenhami e dënon

Tottenham Hotspur ka telashe me sulmuesin Harry Kane. Sulmuesi anglez, prej kohësh në qendër të zërave të merkatos, nuk është paraqitur në grumbullimin e skuadrës në ditën e caktuar pas pushimeve. Një gjest që ka konfirmuar dëshirën e lojtarit për një aventurë të re, me shumë mundësi me fanellën e Manchester City. Një sjellje provokuese që "Spurs" ka vendosur të mos e injorojë. Sipas "Telegraph", në fakt, sjellja e Kane do të ketë pasoja. 28-vjeçari do të dënohet dhe shuma do të rritet çdo ditë që lojtari do të mungojë.

#### PSG-ja në garë për Koulibaly

Paris Saint Germain është fokusuar në blerjen e mbrojtësit të Napolit, Kalidou Koulibaly. Mediat në Francë sigurojnë se drejtori sportiv i skuadrës parisiene, braziliani Leonardo, dëshiron që 30-vjeçari të jetë partner i Sergio Ramosit në qendër të mbrojtjes sezonin e ardhshëm. Shumë klube të tjera dëshirojnë shërbimet e kapitenit të Senegalit, përfshirë Manchester Unitedin, por PSG-ja shpreson ta fitojë garën për nënshkrimin me një prej futbollistëve më cilësorë në qarkullim në këtë rol.

## Unitedi shet 10 futbollistë për ta siguruar dyshen Trippier - Camavinga

Manchester United do t'i shesë 10 lojtarë në mënyrë që të grumbullojë një thesar për ta kompletuar blerjen e Kieran Trippier nga Atletico Madridi

dhe Eduardo Camavinga nga Rennes, raporton "The Sun". Në listën e lojtarëve që mund të sakrifikohen janë lojtarët e huazuar aktualisht

Jesse Lingard, Andreas Pereira dhe Diogo Dalot. Por edhe Axel Tuanzebe që me ardhjen e Varanes nuk do të ketë hapësira. Më pas është Alex

Telles, blerja zhgënjesë e sezonit të kaluar. Edhe Daniel James me Brandon Williams janë në listë, ashtu si Phil Jones dhe Anthony Martial.



**Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë**  
 Me adresë: Rr.Xhem Sadrija pn , Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

**Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë**

**Shpall konkurs publik për këtë vende punës:**

**KONKURS**

**Pozita: PUNËTORI FIZIKË- / NË MBLEDHJEN E HEDHURINAVE**

Vendi i punes Istog (2 pozita)  
 Kontratata për kohë të caktuar.

Puntori ka këto detyra dhe përgjegjësi

1. Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
2. Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazen e Kontenjerve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çeseve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
3. Pas zbrazjes së Kontenjerve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdesë.
4. Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
5. Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepunëtorit dhe Eprorit
6. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejtë Kryeshefit Ekzekutiv

Kualifikimi:

- Shkolla e mesme-
- te ketë përvojë pune.
- Aftësia të mir komunikimi

**Mënyra e Aplikimit:** Aplikacioni merret dhe dorëzohet në ndërtesën e Ndërmarrjes "Ambienti" SH.A Rr Xhem Sadrija pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: 18.08.2021 ora 16:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkoen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Shehrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.A.P " Hysni Zajmi" Gjakovë

► Petrit Lluhani shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Feraset Asllani, Berjahë Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.M.M.U. "Bajram Sadriu" Berjahë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i l-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

**RESTAURANT**

**SWISS TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

